

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
TEAM BLINK SHPK.

Sot me 20 Dhjetor 2021 (dymijë e njëzetë e një), ortaket:

- i. **Divinus Investements shpk**, shoqeri me përgjegjësi të kufizuara me Nipt L81707021H, me adrese, Rruga Papa Gjon Pali II, Arena Center, Hyrja AB, kati i 2, zyra A2/+2 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori z. Florid Ismailaj i biri i Idajetit, i datëlindjes 04.03.1996, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, Rr. "Sami Frasheri", shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit (Pasaporte) nr. BC6757123.

me qellim themelimin dhe regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuara ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit miratojmë Statutin e **TEAM BLINK** ne përputhje me legjislacionin shqiptar, vullnetin tone te shprehur ne aktin e themelimit dhe dispozitat si me poshtë.

KREU I
EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHEZGJATJA

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Shoqëria është krijuar ne formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuara. Emërtimi i shoqërisë është **TEAM BLINK Shpk**. ("Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("Ligji Tregtar"), legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me këtë Statut.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Papa Gjon Pali II, Arena Center, Hyrja AB, kati i 2, zyra A2/+2 Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të krijojë dege, seli dytësore dhe të zhvillojë aktivitet ne vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës se Shqipërisë me vendim të Administratorit/ve.

Neni 3

Objekti i Shoqërisë

- Krijimi, zotërimi, menaxhimi, mbajtja e të drejtave të ekipeve të sportit elektronik ku, shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj ushtrimin e aktiviteteve të ndryshëm, turneve në fushën e sportit elektronik (ESPORTS) në arena kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga federata kombëtare apo ndërkombëtare të sportit elektronik, institucione publike/shtetërore shqiptare, apo të huaja.
- Shoqëria ka për objekt shitje, blerje, prodhim, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve sportivë, veshjeve, aksesorëve, si dhe të çdo artikulli industrial.
- Aktivitete reklamimi, ekspozim i brandit, marketing, ushtrim të aktiviteteve të agjensive publicitare të komunikimeve, medias së shkruar apo radiotelevizive, social media, portale online si dhe dhënia e shërbimeve të lidhura me to.
- Ngritja e shkollave akademike të sportit elektronik, menaxhim lojtarësh të rinj dhe të vjetër sipas kontratave përkatëse.
- Mbajtja e të drejtave të kartonit të lojtarëve sipas kontratave përkatëse.
- Aplikimi, konkurrimi, përfitimi për grante, donacione, financime, sponsorizime, nga burime buxhetore me karakter kombëtarë apo ndërkombëtarë.
- Dhënia e shërbimeve të mësipërme për llogari të palëve të treta, përfshirë këtu shërbime të organizimit administrativ, sportiv dhe tregtar, marrja përsipër dhe menaxhimi i të drejtave kontraktore të çfarëdolloji për llogari të të tretëve, konsulence dhe shërbime administrimi, financiare strategjike, analitike, teknike të sportit Elektronik brënda ose jashtë vendit.
- Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhjet me objektivin e mësipërm.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj prej një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.
- 4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së ortakeve në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është krijuar përmes kontributit cash :
- i. **Divinus Investements shpk** , shoqeri me përgjegjësi të kufizuara me Nipt L81707021H, me adrese, Rruga Papa Gjon Pali II, Arena Center, Hyrja AB, kati i 2, zyra A2/+2 Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori z. Florid Ismailaj i biri i Idajetit, i datëlindjes 04.03.1996, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, Rr. "Sami Frasheri", shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit (Pasaporte) nr. BC6757123.
zotërues i 1 (një) kuote me vlerë **100.000(nje qind mije)** Leke të barasvlershme me 100% të kapitalit të Shoqërisë;
- 6.1 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar dhe ky Statut. Përgjegjësia e Ortakeve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 6.2 Adresa e ortakeve dhe administratorëve për efekt të marrëdhënieve të tyre me Shoqërinë, është ajo që rezulton nga regjistri i ortakeve. Është detyrim i ortakeve të njoftojnë ndryshimin e adresës së tyre. Mbajtja dhe përditësimi i regjistrit është detyrë e Administratorit/ve.

Neni 7

Kontributet dhe Financimet

- 7.1 Kontributi i ortakeve në kapitalin e Shoqërisë mund të jete në para ose në natyrë, si pasuri të luajtshme, të paluajtshme apo të drejta.
- 7.2 Shoqëria, me kërkesë të Administratorit dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, mund të grumbullojë financime nga ortaket, me të drejte kthimi, jo detyruesisht në përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes të secilit në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 8

Transferimi i Kuotave dhe e Drejta e Parablerjes

- 8.1 Dispozitat e këtij neni të Statutit kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unitetit të ortakeve dhe ekuilibrit të marrëdhënieve midis tyre dhe për këtë arsye vendosen kufizimet e mëposhtme, në rastin e transferimit të kuotave.
- 8.2 Kuotat janë lirish të transferueshme; (i) midis ortakeve dhe shoqërive të kontrolluara nga ortaket (ii) midis ortakeve.

- 8.3 Ne rast te transferimit te çdo forme te kuotave (përfshire dhe transferimin pa kundër shpërblim), tek subjekte te ndryshëm nga ata te përcaktuar ne piken 8.2 te këtij neni, transferimi do te kushtëzohet nga ushtrimi i se drejtës se parablerjes nga ortaket e tjerë te Shoqërisë, mbi kuotat te cilat do te transferohen, ne përputhje me rregullat e përcaktuara ne dispozitat vijuese.
- 8.4 Ortaku, qe ka për qellim te shesë apo te transferoje pjesëmarrjen e tij, duhet te njoftoje me letër rekomande te paktën njërin nga Administratoret ne adresën e selisë se Shoqërisë. Njoftimi duhet te përmbaje te dhënat personale te transferuesit te kuotave dhe te përfituesit te tyre, numrin e kuotave qe do te transferohen, kushtet e transferimit, duke përfshire çmimin dhe mënyrat e pagesës.
- 8.5 Administratori brenda 7 (shtate) ditësh nga marrja e njoftimit për transferimin, do te njoftojnë ortaket e Shoqërisë ne lidhje me transferimin ne fjale.
- 8.6 Ortaket, te cilëve iu drejtohet njoftimi si me sipër, duhet te ushtrojnë te drejtën e parablerjes mbi pjesëmarrjen se cilës i referohet njoftimi duke i dërguar ortakut ofrues dhe Administratorit me letër rekomande brenda 30 (tridhjete) ditësh nga marrja e njoftimit, deklaratën e ushtrimit te se drejtës se parablerjes.
- 8.7 Ne rast se ortaket e tjerë dhe ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotave te propozuar ky i fundit, apo me vlerën e tregut ne rastin e transferimit te kuotave pa kundër shpërblim, ata do te caktojnë një ekspert për te përcaktuar çmimin sipas vlerës se tregut, vendimi i te cilit do te jete përfundimtar. Pas njoftimit te çmimit te shitjes se kuotave te përcaktuar nga eksperti, ortaket brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh duhet te njoftojnë me letër rekomande Administratorin dhe ortakun transferues për interesimin e tyre te blejnë kuotat me çmimin e përcaktuar nga eksperti.
- 8.8 Ne rastin e ushtrimit te se drejtës se parablerjes nga ana e me shume se një ortaku, pjesëmarrja e ofruar do t'i takojë ortakeve te interesuar ne përpjesëtim pjesëmarrjen qe zotëron secili ne kapitalin e Shoqërisë.
- 8.9 Nëse një ose disa nga ortaket qe kane te drejtën e parablerjes nuk dëshirojnë apo nuk mund te ushtrojnë ketë te drejte, e drejta e tyre e parablerjes u kalon automatikisht dhe ne përpjesëtim ortakeve te tjerë, nëse ka te tille.
- 8.10 Nëse asnjë nga ortaket nuk ka për qellim te blejë pjesëmarrjen e ofruar sipas mënyrave dhe kushteve te përshkruara këtu, ortaku transferues do te jete i lire t'i transferoje te gjithë pjesëmarrjen blerësit te përcaktuar ne njoftimin dërguar ortakeve te tjerë. Transferimi do te konsiderohet si i miratuar ne heshtje nëse ortakut transferues nuk i paraqitet asnjë njoftim për ushtrimin e te drejtës se parablerjes brenda 30 (tridhjete) ditësh, ose kur nuk është arritur asnjë marrëveshje brenda gjashtëdhjetë 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit te transferimit ne fjale nga ortaku transferues.
- 8.11 E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet për te gjithë pjesëmarrjen e ofruar.

KREU III

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 9

Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

- 9.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakeve te Shoqërisë është organi me i larte vendimmarrës i saj. Ajo përfaqëson te gjithë ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne përputhje me ligjin dhe ketë Statut, janë detyruese për te gjithë ortaket, përfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojnë kundër këtyre vendimeve.
- 9.2 Vendimet për çështjet e mëposhtme te Shoqërisë mund te miratohen ne mbledhjen e asamblesë se përgjithshme te ortakeve ose nëpërmjet konsultimit me shkrim:
- a) përcaktimi i politikave tregtare te Shoqërisë;
 - b) miratimi i ndryshimeve te Statutit;
 - c) emërimi e shkarkimi i Administratorit/eve si dhe përcaktimi i kompetencave dhe shpërblimit te tij;
 - d) emërimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabël te autorizuar si dhe përcaktimi i shpërblimit te tyre;
 - e) mbikëqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori/et, përfshire mbikëqyrjen e përgatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë;
 - f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve përkatës dhe brenda gjashte muajsh nga përfundimi i vitit financiar;
 - g) zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit te Shoqërisë pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve përkatës;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) caktimin e përfaqësuesit te Shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit/eve;
 - j) miratimin e riorganizimit te Shoqërisë, përfshirë bashkimin me shoqëri te tjera, ndarjen, shndërrimin si dhe prishjen e Shoqërisë;
 - k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë se ortakeve.

Neni 10

Përfaqësimi dhe Kuorumi

- 10.1 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamblesë e përgjithshme dhe te votoje sipas kuotave qe zotëron ne kapitalin e Shoqërisë.

- 10.2 Ortaket mund te përfaqësohen ne asamblenë e përgjithshme nga një ortak tjetër apo një person i trete te autorizuar nëpërmjet prokurës me shkrim.
- 10.3 Përveç se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakeve vendos ne mënyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe përfaqësojnë me shume se 30% (tridhjetë përqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me votat pro te me shume se 50% (pesëdhjete përqind) te ortakeve te pranishëm.
- 10.4 Për te vendosur ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimit, riorganizimin ose prishjen e Shoqërisë, asambleja e përgjithshme e ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë te pranishëm ose te përfaqësuar ortaket qe zotërojnë me shume se 50% (pesëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë. Vendimi merret me votën pro te te paktën 75% (shtatëdhjetë e pese përqind) te ortakeve te pranishëm.
- 10.5 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te vendose për shkak te mungesës se kuorumit te përcaktuar me lart, ajo mbledhet përsëri jo me vone se 30 (tridhjetë) dite, me te njëjtin rend dite.

Neni 11

Thirrja e Asamblesë se Përgjithshme

- 11.1 Asambleja e përgjithshme e ortakeve duhet te thirret te paktën një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit te ecurisë se veprimtarisë te Shoqërisë te hartuar nga Administratori/et, si dhe çdo here qe gjykohet e nevojshme nga Administratori/et, si dhe kur kjo kërkohet me shkrim nga një ose disa ortake qe zotërojnë te paktën 5% (pese përqind) te kapitalit te Shoqërisë. Ne rastin e fundit nëse Administratori/et nuk e thërret asamblenë brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga paraqitja e kërkesës se ortakeve te sipërpërmendur, këta te fundit kane te drejte ta thërresin vete asamblenë e përgjithshme te ortakeve, duke përcaktuar rendin e ditës, kohen dhe vendin e takimit ne përputhje me procedurat e përcaktuara ne dispozitat ne vijim.
- 11.2 Gjithashtu asambleja e ortakeve thirret ne rastet kur:
- (a) sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
 - (b) Shoqëria propozon te shesë apo te disponoje ne mënyre tjetër aktive, te cilat kane një vlere me te larte se 5% (pese përqind) te aseteve te Shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - (c) Shoqëria, brenda 2 (dy) viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga një ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pese për qind) te aseteve te Shoqërisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 11.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve mbledhet ne selinë ligjore apo pranë një vendi tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.
- 11.4 Mbledhja e asamblesë se përgjithshme te ortakeve thirret me ane te një njoftimi me shkrim te dërguar me poste te regjistruar ose faks ose nëpërmjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve. Njoftimi duhet te tregojë rendin e ditës, vendin, datën dhe

- orën e mbledhjes dhe do t'i dërgohet secilit ortak, jo me vone se 7 (shtate) dite përpara datës se parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Gjithashtu, njoftimi duhet të përmbaje, edhe mënyrën e pjesëmarrjes ne asamblenë e ortakeve dhe/ose mënyrën e vendimmarrjes.
- 11.5 Njoftimi i mbledhjes mund të parashikojë edhe një datë të dytë për mbledhjen e asamblesë në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit, në përputhje me përcaktimin në nenin 10.5 të këtij Statuti.
- 11.6 Në rastin kur njoftimi i mbledhjes bëhet nëpërmjet postës elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marrë nga ortakët në datën/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të njoftimit të postës elektronike.
- 11.7 Në rastin kur njoftimi i mbledhjes bëhet me faks, njoftimi konsiderohet i marrë nga ortakët në datë/orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të gjeneruar nga pajisja e faksit.
- 11.8 Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme të ortakeve dhe vendimet e saj janë të vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjesë të gjithë ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e Shoqërisë.
- 11.9 Asambleja e përgjithshme e ortakeve kryesohet nga personi i emëruar nga shumica e ortakeve pjesëmarrës (në vijim i quajtur "Kryetari i Mbledhjes").
- 11.10 Kryetari i Mbledhjes emëron sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes së asamblesë.
- 11.11 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunikimit video-shkrues.
- 11.12 Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakeve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme që:
- (i) Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortakët të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbarëvajtjen e mbledhjes, të numërojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
 - (ii) Sekretari dhe/ose mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
 - (iii) Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmeve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
- 11.13 Mbledhja e asamblesë në kushtet e përmendura në nenin 11.11 dhe vijues të këtij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur në vendin ku është i pranishëm Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtësi i procesverbalit, i cili bën të mundur përgatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
- 11.14 Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
- 11.15 Në rast se ortakët janë të ftuar të marrin vendime nëpërmjet konsultimit me shkrim, kuorumi do të quhet si i formuar bazuar në numrin e ortakeve që do të dërgojnë votimin dhe

vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose ortakët e qe kërkojnë vendimmarrjen duhet t'i dërgojnë çdo ortaku njoftimin për konsultimin me shkrim, i cili do të përmbajë gjithë informacionet që përfshihen në letrën e njoftimit/thirrjes të përcaktuar në nenin 11.4 të këtij Statuti. Procedura e konsultimit me shkrim duhet të kryhet në përputhje me përmbajtjen e këtij neni, në rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet të shprehet me shkrim në lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve në formën e dërguar nga Administratori, nëpërmjet shënimit "pro" ose "kundër" ose duke u shprehur komentet e tyre në një dokument tjetër. Në rast se ortakët kanë komente, duhet t'u bëjnë reference të qarte projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t'i dërgojë Administratorit ose ortakëve që kanë kërkuar marrjen e vendimit nëpërmjet këshillimit me shkrim, votën e tij/vendimet me shkrim brenda datës së përcaktuar në njoftimin e dërguar për marrjen e vendimit nëpërmjet konsultimit me shkrim.

- 11.16 Vendimet e ortakëve të marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet të pasqyrojë mënyrën e organizimit të mbledhjes së asamblesë apo të konsultimit me shkrim nëse është kryer në përputhje me ligjin dhe depozitat e Statutit, të identifikojë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar ose ortakët që kanë votuar me shkrim, nëse kuorumi i ortakëve që kanë votuar me shkrim është respektuar sipas Statutit dhe Ligjit Tregtar, si dhe nëse vendimet konsiderohen të miratuara sipas votave të marra. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbalit i bashkëngjitet gjithashtu lista e ortakëve që kanë votuar (përveç rastit kur procesverbali është nënshkruar nga gjithë ortakët) si dhe njoftimi i thirrjes së asamblesë të cilat mbahen në selinë e Shoqërisë. Nëse vendimet e marra nga ortakët duhet të depozitohen pranë Regjistrisë Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhëna (nëpërmjet konsultimit me shkrim nga ortakët) do të shërbejnë si dokumentet që provojnë të dhënat që do të depozitohen në këtë regjistër.
- 11.17 Në rast se asambleja e përgjithshme e ortakëve nuk mund të shqyrtoje në të njëjtën ditë të gjitha çështjet që duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do të bëhet të nesërmen pa pasur nevojë për njoftim të mëtejshëm.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Administrimi i Shoqërisë

- 12.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga 1 (një) Administratorë .
- 12.2 Administratorët do të emërohen nga asambleja e ortakëve dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.
- 12.3 Administratorët do të jenë persona fizik pa asnjë kufizim për sa i përket kombësisë së tyre. Afati i emërimit të Administratorëve do të caktohet në momentin e emërimit të tyre por ky afat nuk mund të jete më i gjatë se 5 (pese) vjet. Pa cenuar këtë kufizim afati i emërimit të tyre mund të ripërtërihet me vendim të asamblesë së ortakëve.

- 12.4 Administratori do te rimbushet për shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij. Asambleja e ortakeve mund te vendose te japë edhe shpërblime vjetore.
- 12.5 Ne rast dorëheqje Administratori do te njoftoje me shkrim asamblenë e ortakeve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së Shoqërisë do të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit/ve

- 13.1 Administratoret do te jete përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe do te përfaqësojnë Shoqërinë kundrejt palëve te treta ne përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose te ligjit te zbatueshëm. Administratoret kane kompetenca te plota te marrin vendime te zakonshme dhe te jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqërisë sipas këtij Statuti ose ligjit te zbatueshëm.
- 13.2 Administratoret do te kenë kompetenca te plota për te vepruar, bashkërisht ose veçmas, për sa i përket detyrave qe lidhen me administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë se Shoqërisë si me poshtë:
- (a) te mbikëqyrin dhe te zbatojnë politikat tregtare te Shoqërisë dhe vendimet e asamblesë se ortakeve;
 - (b) te sigurojnë qe Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standardet kontabël;
 - (c) te kryejnë te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare te Shoqërisë;
 - (d) te përfaqësojnë Shoqërinë kundrejt palëve te treta;
 - (e) te sigurojnë qe dokumentet dhe librat kontabël te Shoqërisë te mbahen rregullisht;
 - (f) te thërrasin mbledhjet e asamblesë se ortakeve, nëse e vlerëson te nevojshme për mbrojtjen e interesave te Shoqërisë;
 - (g) te përgatisin dhe nënshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqërisë, dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë te cilat bashke me propozimin për shpërndarjen e fitimit i paraqiten për miratim asamblesë se ortakeve.
 - (h) te kryejnë te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqërinë sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshëm;
 - (i) t'i raportojnë asamblesë te ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendësi te veçante për Shoqërinë;
 - (j) te punësojnë ose te ndërpresin marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave te Shoqërisë.
 - (k) te kryejnë detyra te tjera te përcaktuara ne ligj dhe ne Statut.

- 13.3 Administratoret mund të ushtrojnë, bashkërisht ose veçmas të gjitha kompetencat si dhe të kryejnë të gjitha veprimet të cilat me ligj ose nga ky Statut tjetër nuk i rezervohen kompetencave të asamblesë së ortakeve ose nuk kufizohen nga ky Statut apo nga ligji i zbatueshëm.
- 13.4 Administratori i pare të Shoqërisë të emëruar për një afat 5 (pese) vjeçar nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar do të jetë:
- 13.5 **Holger Cara**, i biri i Arturit, i datëlindjes 18.05.1996, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr. "Aleksander Moisiu", shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit J60518035U.
- 13.6 Ndryshimi i Administratoreve, nuk do të përmbajë një ndryshim të Statutit të Shoqërisë. Përditësimi i të dhënave në Regjistrin Tregtar do të kryhet me depozitimin e aktit të emërimit të administratoreve vijues.

Neni 14

Përgjegjësitë e Administratorit/ve

- 14.1 Administratoret për një veprim të caktuar në të cilin përfshihen interesat e tij ose të palëve të treta të lidhura me të, të cilat i kundërvihen interesave të Shoqërisë duhet të njoftojnë asamblesë së ortakeve si dhe mund të mos marrë pjesë në vendimet që lidhen me këto veprime.
- 14.2 Administratoret, kur personalisht apo përmes palëve të lidhura me të ashtu siç përcaktohen në nenin 13 të Ligjit Tregtar, kanë interesat në marrëveshje të cilat do të lidhen nga Shoqëria duhet të njoftojnë asamblesë së ortakeve. Përfundimi i një marrëveshjeje të tillë duhet të miratohet nga asambleja e ortakeve.
- 14.3 Administratoret duhet të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë të kujdesshme në përputhje me këtë Statut, ligjin në fuqi dhe vendimet e asamblesë së ortakeve.

KREU V

VITI USHTRIMOR-KONTROLI KONTABEL-PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 15

Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Në përfundim të çdo viti financiar, Administratori/et harton pasqyrat financiare në përputhje me ligjin.

Neni 16

Fitimi dhe Dividentet

- 16.1 Fitimet qe rezultojnë nga pasqyrat financiare te miratuara rregullisht, do te shpërndahen midis ortakeve ne përputhje me kuotat e zotëruara, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe nga ortaket ne mbledhjen e asamblesë se ortakeve ose nëpërmjet konsultimit me shkrim, ose do te përdoret për qëllime te tjera sipas vendimit te asamblesë se ortakeve.
- 16.2 Fitimi qe mund te shpërndahet tek ortaket konsiston ne fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar ne vitet e kaluara dhe te mbartur, fitimi i realizuar ne vitet e kaluara i cili ishte destinuar për rezervën ligjore, kur qëllimi i krijimit te rezervës është përmbushur dhe ortaket vendosin te shfuqizojmë rezervën ne fjale.

KREU VI

KONTROLLI KONTABEL

Neni 17

Kontrolli

Nëse kërkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emërohen nga asambleja. Asambleja e ortakeve mund te riemëroje te njëjtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te asamblesë se ortakeve ne rast mosrespektimi te detyrës se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

KREU VII

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

- 18.1 Asambleja e ortakeve mund te vendose për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do te shoqërohet me likuidimin e saj.
- 18.1 Shoqëria vazhdon te ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja te likuidimit deri ne përfundim te këtij procesi dhe gjate likuidimit togfjalëshi "ne likuidim e sipër" duhet te vihet pas emrit te Shoqërisë.
- 18.1 Likuiduesi/t do te emërohet me vendim te asamblesë se ortakeve. Emërimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 19

Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

- 19.1 Për çështjet e parregulluara ne ketë Statut do te zbatohet Ligji Tregtar.
- 19.2 Çdo konflikt, divergjence, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdo lloji, sido që te ketë lindur nga apo ne lidhje me ketë Statut, do t'i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Ky Statut i Shoqërisë u hartua ne katër (4) origjinale ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM

DIVINUS INVESTEMENTS PERFAQWSUAR NGA ADMINISTRATORI I SAJ

z.Florid Ismailaj.



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Florid Ismailaj". The signature is fluid and cursive.